ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **Autoritetit Kontraktues – Ministria e Infrastrukturës**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **205-24-3725-5-1-1**

Sa i përket tenderit për **"Vendosja e Sinjalizimit dhe pasijeve rrugore ne Autoudhen R7, Morin Gjurgjicë, segmenti Fushe Kosove - Besi si dhe R6 kryqezimi R6 R7 Rreth Rrotullimi R6 R25.2"**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

"TSR" Sh.P.K.

Rr. "Fehmi Lladrovci" nr. 99

Fushë Kosovë *12000*

+383 (0)44 34 13 68

Marksim Malsijaj, Drejtor

info@tsr-ks.com

08.09.2024

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës","Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

B05 Njoftimi për Kontratë & Dosja e Tenderit – 17.04.2024

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☐ **Jo** ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒ **Jo** ☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se. F02 Kërkesë për rishqyrtim – 23.08.2024 Vendimi mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim – 29.08.2024

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 7 i LPP lidhur me nenin 27 dhe 28 të LPP

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë te rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Autoriteti Kontraktues (tutje si "AK") me datë 17.04.2024 ka publikuar dosjen e tenderit ku ndër të tjera ka përcaktuar disa kërkesa diskriminuese në kundërshtim me nenin 7 dhe 53 të LPP lidhur me nenin 27 dhe 28 të LPP.

Me datë 06.08.2024 OSHP ka publikuar vendimin 2024/0452 përmes të cilit ka miratuar si të bazuar ankesën e TSR Sh.P.K. kundër kërkesave të dosjes së tenderit respektivisht specifikave teknike dhe paramasës. Përmes pikës 2 të këtij vendimi, OSHP ka detyruar AK që të bëj përmisimet e nevojshme në dosjen e tenderit sipas të gjeturave të vendimit. Me datë 20.08.2024 AK ka publikuar formularin për korrigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara mirëpo me këtë rast nuk ka realizuar të gjitha përmisimet në dosjen e tenderit që janë kërkuar përmes vendimit të OSHP. Rrjedhimisht në DT vazhdojnë të ekzistojnë kërkesa diskriminuese dhe në kundërshtim me nenin 7 lidhur me nenin 28 dhe 29 të LPP.

Pretendimi nr. 1 – Në kuadër të specifikave teknike AK kërkon që materialet themelore të përdorura për shënimin e rrugës të jenë "nga masat e përziera plastike të nxehtë (termoplastike)". Një kërkesë e tillë jo vetëm që është në kundërshtim me LPP por edhe me vendimin e OSHP nr. 2024/0452 përmes të cilit specifikisht thuhet që AK duhet të lejoj edhe përdorimin e materialeve tjera ekuivalente respektivisht të ngjashme apo më të avancuara dhe të mos kufizohet vetëm në materialet termoplastike. Mirëpo edhe përkundër vendimin të OSHP të sipërcituar, AK sërish në mënyrë kufizuese dhe diskriminuese ka përcaktuar në kuadër të specifikave që materialet themelore të përdorura për shënimin e rrugës të jenë "nga masat e përziera plastike të nxehtë (termoplastike)". Rrjedhimisht kërkojmë nga AK që të gjej këtë pretendim ankimor si të bazuar ashtu që të ndryshoj/plotësoj këtë pikë të specifikave teknike duke lejuar që përpos materialeve termoplastike të lejohen edhe materialet tjera të ngjashme apo ekuivalente apo më të avancuara për shënimin e rrugës duke përfshirë këtu edhe materialin nga plastika e ftohtë.

Pretendimi nr. 2 – Në kuadër të specifikave teknike AK kërkon që (përpos kërkesës diskriminuese për material termoplastik), në figura vijat e mesit, vijat ndarëse dhe vijat anësore të shiritave gjatësor të rrugës duhet të punohen nga masat termoplastike të ashtuquajtura "multi-dot" sikurse në figurën vijuese me nr. 2.2.

Fig.2.2. Format e shiritave të mesit të rrugës “multi-dot”

Në vendimin OSHP:2024/0452 përcakton shprehimisht se përpos formës “multi-dot”, AK duhet të lejoj edhe forma tjera të vijave me materiale tjera ekuivalente (jo vetëm termoplastike por edhe plastikë të ftohtë). Prandaj në pikën 19.6 te specifikimet teknike në pjesën ku kufizohet forma e pikave vetëm në “multi-dot” dhe materiali vetëm si “termoplastik”, OSHP ka kërkuar nga AK që të ndryshohen/plotësohen ashtu që të lejohen edhe forma (dhe materiale) të tjera të ngjashme, ekuivalente ose më të avancuara. Pra të futet termi “ose e barasvlefshme/ekuivalente” me qëllim që të mos kufizohet konkurrenca e lirë e operatorëve ekonomik. Në këtë rast si forma të ngjashme mund të manifestohen format e rrumbullakëta, katërore, Agglomerat etj. Qëllimi i këtyre pikave është paralajmërimi i vozitësve gjatë ndërrimit të shiritëve në rrugë. Ky efekt arrihet pavarësisht formës dhe mbi të gjitha, ky efekt arrihet edhe me materiale tjera dhe jo vetëm me material termoplastik.

Se ka vizim te till dhe perdort ne vende edhe me te zhvilluara apo ne vende te Europes bashkangjisim foto me matrijal termoplastik te ftoht 2Komponeteshe.



Regelmäßiges_Agglomerat me plastikë të ftohtë 2K

Unregelmäßiges_Agglomerat me plastikë të ftohtë 2K

Duke marrë parasysh këto fakte, kërkojmë nga OSHP që të miratoj si të bazuar këtë pretendim ankimor ashtu që të riformulohet kërkesa e AK për formën e vijave duke mos u kufizuar vetëm në formën multi-dot por të lejohen edhe forma tjera të ngjashme, ekuivalente ose më të avancuara të cilat përdoren edhe në vende më të avancuara dhe me përvojë më të gjatë të sinjalizimt Horizontal në pjesë të ndryshme të Evropës.

Pretendimi nr. 3 – AK te paramasa bën shkelje të LPP pasi që nuk ka përcaktuar saktësisht se sa metra duhet të jenë për fshirje apo për grryerje të vijave ekzistuese! Fjala është për kërkesën e AK në paramasën aktuale lidhur me shlyerjen e vijave ekzistuese pa dëmtimin e shtresës qarkulluese (asfaltit) në komplet segmentin rrugor, fshirja/larja. Në këtë rast operatorët ekonomik nuk kanë informacione të sakta se sa është hapësira për të shlyer, gryrrë, larë (etj) vijat ekzistuese pa dëmtuar shtresën qarkulluese të asfaltit. Ne dyshojmë që disa OE tanimë e kanë siguruar informacionin se për çfarë distance po bëhet fjalë. Natyrisht që një informacion i tillë është shumë i rëndësishëm dhe siguron përparësi të konsiderueshme për disa OE. Në mënyrë që AK të trajtoj të gjithë OE në mënyrë të barabartë, është e domosdoshme që AK të shtoj një pozicion të ri në paramasë lidhur me kërkesën në fjalë për shlyerjen e vijave ekzistuese në gjatësinë e plotë apo vetëm ku është e nevojshme. Vendosja e një pozicioni të tillë të posaçëm para vizatimit (çmimi për 1m²) do t'i largonte dyshimet për manipulime të mëvonshme dhe qasje diskriminuese ndaj disa OE tenderues, dhe njëkohësisht OE pjesëmarrës do të ishin në gjendje që të kalkulojnë shpenzimet sa duhen për kët pozicion. Njëkohësisht në qoftë se njësia kërkuese nuk e din saktë se sa metra të vijës së vjetër do të duhet të shlyhen (grryhen), atëherë do të mjaftonte të kërkoj që të jepet çmimi për 1m² e jo të manipulohet në këtë formë më kërkesa të tilla kur dihet që ky pozicion ka shpenzime të shumta shtesë dhe në qoftë se disa OE të previligjuar e kanë informacionin paraprakisht për metrat e sakta që duhet të shlyhen/grryhen, atëherë kjo është kreit normale që do të përdorin ato informacjone dhe do të ketë manipulime me çmime nga disa OE të caktuar. Natyrishëm në një situatë të tillë ne si OE do të diskriminohemi deri në masën që do të n'a pamundësohet konkurrenca e lirë rrjedhimisht edhe marrja e kontratës. Andaj lind pyetja se pse nuk vendoset ky pozicion i veçantë përderisa kërkohet edhe makineri e veçantë për kët pozicion (siç kërkohet edhe makineri për preimerin).
Pretendimi nr. 4 – AK te paramasa bën shkelje të LPP pasi që nuk ka përcaktuar saktësisht trashësinë e termoplastikës edhe pse kemi një vendim të OSHP:2024/0452 sa i përket kësaj pike, ktu AK përseri te specifikacioni teknik thotë se "Trashësia e shtresës së tharë duhet të jetë 3.00 toleranca +/- 10%". Rrjedhimisht përcaktimi i trashësisë 3mm me tolerancë vetëm +/- 10% është absolutisht e pamjaftueshme dhe diskriminuese.

Nga sa u tha më sipër është argumentuar me prova të matshme dhe të pakontestueshme se dosja e tenderit përmban kërkesa të cilat janë diskriminuese/favorizuese dhe si të tilla në kundërshtim me nenin 7 të LPP lidhur me nenin 27 dhe 28 të LPP si dhe nenin 72 të LPP. Prandaj propozojmë që pas shqyrtimit të kësaj ankese, Paneli Shqyrtues të merr këtë:

VENDIM

MIRATOHET si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik "TSR" Sh.P.K. ashtu që **DETYROHET** Autoriteti Kontraktues – Ministria e Infrastrukturës që të publikoj formularin për korrigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara përmes të cilit do të korrigjohen kërkesat e dosjes së tenderit të përcaktuara më sipër në këtë ankesë.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Do të precizohen.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".
c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,
f) Dëshminë e pagesës se tarifës se ankimit ne përputhje me nenin 118 te LPP-se, dhe
g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*